



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **07.11.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*”, e caktuar me vendimin nr. 54, datë 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar ndaj **personit nën hetim Arsen Caka**”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 238 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 135, datë 09.11.2024, vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit ndaj personit nën hetim **Arsen Caka**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale penale “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi kriminal*” të parashikuara nga nenet 298/2 - 28/4; 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal, të masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar me vendimin Nr. 54, datë 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Urdhërohet Policia Gjyqësore, që personi nën hetim Arsen Caka, të dërgohet menjëherë në institucionin e paraburgimit, për të qëndruar aty në dispozicion të organit procedues.
3. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar dhe shërbimet e policisë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brënda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 09.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar